



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e IX-të (VIII-të për v. 2010) e Kuvendit Komunal në Vushtri, mbajtur më 30.9. 2010

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë.

Ferit Idrizi- propozoi që nga pika nr. 12 të hiqet kërkesa e Njazi Ejupit, nga Vushtrria për dhënie të pronës me qira. Kurse në “të ndryshme” propozoi që të futen: a. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të komunës në Vushtri; b. Kërkesë për rritje të të hyrave vetanake për shkollat e mesme profesionale të komunës për v. 2010-2011; c. Kërkesë për marrje me qira të pronës së komunës.

Bajram Mulaku- arsyetoi propozimin për heqjen e kërkesës së Njazi Ejupit, dhe poashtu arsyetoi propozimet shtesë të paraqitura nga Kryesuesi i Kuvendit për në “të ndryshme”.

Xhemajl Pllana- informoi Kuvendin lidhur me dorëheqjen e tij nga GP i PDK-së, si vijon:

Me keqardhje për shumë nga kolegët e mi të respektuar në GP të PDK-së, ju njoftoj se, që prej seancës së sotme, unë nuk do të jem më delegat i Grupit Parlamentar të PDK-së. Tani e tutje do të jem delegat i pavarur i këtij Kuvendi. Besoj se shumica nga ju i dini arsyet dhe pakënaqësitë e mia lidhur me ndërtimin e administratës komunale, mënyrën e vendimmarrjes dhe mënyrën e funksionimit të Kuvendit

Komunal. Heshtja ime ishte një heshtje dëshpërime e zhgënjimi për atë se për çfarë kishim luftuar e për çfarë po vepronim në praktikë: për privilegje individuale a grupore. Unë isha i anashkalluar dhe i diferencuar nga persona të veçantë të subjektivitetit tim nga çdo lloj pozite hierarkike institucionale. Unë mbase ndonjëherë edhe kam ditur t'i kritikoj kolegët e mi, por vërejtjet ose kritikën i kam bërë me qëllim të mirë. Ato kanë qenë miqësore e dashamirëse, sepse i bëja për interesa të përgjithshme e në shërbim të popullit dhe shtetit tonë. Për çudi, pavarësisht propozimeve e premtiveve nga lartë e nga poshtë, nuk më ofruan as edhe një post prej "shërbëtori" për të qenë i dobishëm! Përveç të tjerave, unë në momentet më të vështira kisha sakrifikuar e luftuar edhe me armë në dorë për lirinë, për shtetin dhe për institucionet që po ndërtojmë. Kisha qenë në postet më të larta në pushtetin lokal, isha njëri ndër themeluesit e degës së PDK-së dhe gjithashtu isha delegat vendor në të gjitha mandatet e pasluftës.

Qazim Azemi- në emër të grupit asambleistë të AAK-së paraqiti disa vërejtje, propozime dhe komente rreth rendit të ditës: në programin e punës të këtij kuvendi për muajin shtator janë paraparë disa pika, e ato mungojnë, e ndër to është përgatitja për vitin shkollor 2010-2011, pastaj rikthimi i dy draft-rregulloreve për arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ultë dhe të lartë, poashtu mungon edhe një aktivitet që është realizuar "Ditët e Hasan Prishtinës". Mandej tha se pika 2 e rendit të ditës duhet të shkron në diskutim publik. Gjithashtu kërkoi që për pikën nr. 12 të shpallet një tender publik, pasi që nuk janë bërë përgatitjet e duhura, dhe janë marrë vendime në kundërshtim me ligjin sepse nuk ka pasur fare transparencë, nuk ka pasur thirrje publike, tender për pjesëmarrje në konkurrim, nuk ka pasur qasje dhe mundësi të barabarta të pjesëmarrjes së qytetarëve në konkurrim, dhe shtoi se nuk ka të dhëna as për përfituesit, se kush janë, cilat janë përvojat e tyre, bizneset, kapitali, mundësitë, dhe njoftoi se ka të dhëna që janë refuzuar edhe kërkesat e bijve të Dëshmorëve për të shfrytëzuar këto pasuri të Komunës. Në fund kërkoi që rendi i ditës të mos stërngarkohet.

Refik Ramaj- në emër të grupit asambleistë të LDK-së kërkoi që të hiqen 4 pika të rendit të ditës. Pika 2, pasi që është në kundërshtim me ligjin, sepse parashihet buxheti i Drejtorisë së Bujqësisë, e cila drejtori nuk ekziston. Pastaj pika 6 e rendit të ditës është në kundërshtim me ligjin, sepse duhet me qenë një grup ekspertësh, e jo asambleistë. Gjithashtu pika 11 e rendit të ditës është në kundërshtim me ligjin, pasi që kjo duhet të vjen si nismë, e jo si propozimvendim nga Kryetari. Edhe pika e 12-të e rendit të ditës të hiqet, pasi që asnjëri prej ofertuesve nuk ka sjellë biznes plan, në bazë të cilit do të kuptohej se bizneset e tyre kanë perspektivë dhe ka benefite Komuna. Në vazhdim paraqiti vërejtje për renditjen e pikave të rendit të ditës, duke shtuar që pika e 11-të e rendit të ditës do të duhej të ishte pika e 2-të, pasi që Statuti është njëra prej çështjeve më të rëndësishme. Në fund paraqiti shqetësimin për mungesën e informatës për përgatitjet për fillimin e vitit shkollor.

Sabit Kadriu- tha se në një pikë të veçantë të rendit të ditës është dashtë të jetë informata për fillimin e vitit të ri shkollor 2010-2011. Pastaj tha se është bërë një muaj që ka filluar viti i ri shkollor, por gjimnazi "Eqrem Qabej", shkolla e mesme teknike "Lutfi Musiqi" dhe shkolla fillore "Andon Zako Çajupi" nuk janë duke punuar në objektet e tyre, dhe shtoi se dy shkollat e mesme punojnë jashtë objekteve të tyre, me orar tepër të shkurtuar, kurse shkolla fillore "Andon Zako Çajupi" nuk ka filluar punën fare.

Islam Krasniqi- paraqiti kërkesën që fshatit Pestovë t'iu mundësohet ndërtimi i një Xhamisë, duke shtuar që banorët e fshatit kanë bërë kërkesë disa herë, dhe janë 105 familje që janë pro, kurse 5 familje janë kundër, duke kërkuar që të futet në "eventuale", ose të futet në rend dite për seancën e radhës.

Bahrije Pllana- kërkoi që në "eventuale" të diskutohet për nxejme qendrore për shkollën fillore "Bahri Kuçi", pasi që komuniteti ka dorëzuar kërkesë edhe në Drejtorinë e Arsimit dhe në Drejtorinë e Financave, poashtu komuniteti ka mbledhur

3.444 €, kurse projekti kushton 10.000 €, prandaj duhet shikuar mundësinë që projekti të realizohet me mjete tjera financiare nga Komuna.

Muharrem Shabani- lidhur me rendin e ditës, tha se për çështje kapitale dhe me rëndësi duhet të respektohen procedurat e duhura dhe të zhvillohet një procedurë më transparente. Pastaj tha se nuk është kundër ndërrimit të lokacionit të ndërtesës së Kuvendit të Komunës, por kërkoi që të kalon kjo çështje përmes KPF-së, dhe të merret mendimi edhe i qytetarëve, pasi që me dekada janë mësuar të jetë këtu ku është objekti aktual, dhe të shikohen edhe mundësitë tjera eventuale. Mandej si vend të përshtatshëm për ndërtimin e ndërtesës së re të Komunës propozoi hapësirën ku ka qenë ish-kazërma e TMK-së. Pastaj lidhur me pikën tjetër shtesë nën “c” të rendit të ditës, tha se është çështje ku po shkelet ligji, duke bërë dhënie të drejtpërdrejt të kontratës, prandaj kërkoi që përfaqësuesit e Kuvendit të spastrojnë marrëdhëniet pronëso-ro-juridike me këtë pronë, sepse kjo pronë iu është dhënë Kuvendit në shfrytëzim nga ana e UNMIK-ut, pasi që nuk është pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Zeqir Hasani- lidhur me propozimin nën “c” në “eventuale”, propozoi që të merret një iniciativë dhe të krijohet qendra e regjistrimit të automjeteve në atë pikë, pasi që qytetarët e Vushtrrisë janë shumë të maltretuar me regjistrimin e automjeteve të tyre.

Esat Beka- propozoi që në “eventuale” të futet si pikë e rendit të ditës çështja e arsimit.

Besim Jashari- lidhur me pikat shtesë, siç është ndërtimi i objektit të Komunës, kërkoi që të mos nxitohet Kuvendi dhe të merr vendim, pasi që kjo çështje prek interesin e përgjithshëm dhe sa më shumë qytetarë të përfshihen në vendimmarrje, aq më i qëlluar do të jetë vendimi.

Nasuf Aliu- paraqiti sqarime shtesë lidhur me pikën 12-të të rendit të ditës.

Refik Ramaj- tha se biznesi plani nuk është prezantuar, duke shtuar se për t’u analizuar një biznes plan nevojitet një javë kohë, kurse për t’u punuar një biznes plan, nevojitet minimum një muaj e gjysmë, prandaj propozoi që të dorëzohen ato biznes plane, të studiohen nga anëtarët e Kuvendit dhe në seancën e radhës të bëhet shqyrtimi dhe aprovimi eventual i tyre.

Idriz Muzaqi- tha se nevoja për plotësim dhe ndryshim të Statutit të Komunës është shumë e madhe, dhe propozoi që Kuvendi ta formon një komision dhe t’i ipet një afat komisionit në fjalë, në mënyrë që të del me propozime për ndryshimin dhe plotësimin edhe të çështjeve tjera të Statutit, të cilat komisioni i vlerëson të arsyeshme.

Sabit Kadriu- pyeti pse nuk është në rend dite çështja e arsimit?

Qerim Selimi- njoftoi se dy rregulloret e arsimit nuk janë paraqitur në Kuvend, pasi që mësimdhënësit kanë qenë në pushime. Gjithashtu edhe për këtë seancë kanë qenë në pushim, duke premtuar se do t’i procedojnë në mbledhjen e ardhshme. Kurse lidhur me kërkesën e B.Pllanës, premtoi që si DKA do t’iu ndihmojnë banorëve të fshatit në fjalë për realizimin e atij projekti. Në fund kërkoi falje për mungesën e përgatitjes së raportit për fillimin e vitit të ri shkollor, duke premtuar që do ta sjellë raportin në fjalë në seancën e radhës.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 20 vota “për”, 14 “kundër” dhe 1 “abstenim” aprovoi këtë:

Nga pika 12 e rendit të ditës të hiqet kërkesa e Njazi Ejupit, dhe në “eventuale” të inkorporohen propozimet e Ferit Idrizit.

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës më dt.29.07.2010.
2. Shqyrtimi planifikimit buxhetor të komunës dhe projekteve prioritare për vitin 2011. (referues:Isuf Jashari)
3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2011. (referues:Isuf Jashari)
4. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat buxhetore për muajin Korrik dhe Gusht 2011. (referues:Isuf Jashari)
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për plotësim të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale. (referues:Idriz Ismajli)
6. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për formimin e Bordit Këshillëdhënës për dhënien e këshillave në planet rregulluese të qytetit. (referues Idriz Ismajli).
7. Shqyrtimi i propozim vendimit për ridestnim të mjeteve për bashkëfinancim të projektit për rinovim të objektit të ish TMK-së në Vushtrri (vlera 14.416.50 €).(referues:Qamil Sahiti)
8. Shqyrtimi i propozim vendimit për renovim të objektit – shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit, për muze të qytetit. (referues:Qamil Sahiti)
9. Shqyrtimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të tokës ndërtimore pronë e Komunës.
10. Shqyrtimi i propozim vendimit për rindërtim të Kullës së Azem Bejtes në Galicë. (referues:Qamil Sahiti)
11. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës. (referues:Idriz Muzaqi).
12. Shqyrtimi i propozim vendimeve për dhënien në shfrytëzim të përkohshme me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës sipas kërkesave të:
 - Musa Caka nga Stanovci i Epërm
 - Jeton Klinaku nga Vushtrria
 - Isa Hajrizi nga Vushtrria
 - Haki Bekteshi nga Stanovci i Poshtëm,
 - Kreshnik Basholli nga Vushtrria,
 - Shyqyri Selmani nga Progovci Komuna e Prishtinës, (referues: Nasuf Aliu).
13. Eventuale:
 - a. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të komunës në Vushtrri;
 - b. Kërkesë për rritje të të hyrave vetanake për shkollat e mesme profesionale të komunës për v. 2010-2011;
 - c. Kërkesë për marrje me qira të pronës së komunës.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës më dt.29.07.2010.

Pajazit Pllana- në diskutimin e tij kërkoi që të korrigohej dhe të bëhet 14.07.2010. Pastaj fjalja “drejtorinë e kanë lajmëruar se Ministria e Shëndetësisë dëshiron me bërë” të korrigohej dhe të thuhet: “dëshiron të bëjë”. Në fund kërkoi të shtohet edhe një pasus në Deklaratë: Donacioni me karakter ndërkombëtar që iu ka

dedikuar Vushtrisë, nuk mund të privatizohet, nuk iu nënshtrohet procedurës së privatizimit.

Ismet Gashi- lidhur me pikën 11 të rendit të ditës, në pjesën e diskutimit të tij kërkoi që fjalia: “vendimi është asambleistë, i formës së prerë”, të korrigojohet dhe të thuhet “vendimi është i formës së prerë”.

Edhe pse nuk kishte vërejtje për procesverbal, paraqiti këqë qëndrim:

Makfirete Ademi- tha se në seancën e fundit i ka parashtruar dy pyetje, por nuk ka marrë asnjë informatë, dhe përsëri kërkoi që t’iu përgjigjen në pyetjet e njëjta.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes së fundit të Kuvendit të Komunës, me vërejtje e paraqitura nga: P.Pllana, I.Gashi.

2. Shqyrtimi planifikimit buxhetor të komunës dhe projekteve prioritare për vitin 2011. (referues:Isuf Jashari)

Refik Ramaj- tha se draft buxheti i ka disa mangësi. Pastaj tha se buxheti ka mundur të jetë më i madh te pjesa e të hyrave vetjake. Mandej rikujtoi se ka paraqitur një ide për të bërë një planifikim real, pra një raport menaxherial. Në vazhdim në faqe 3, te granti i përgjithshëm është një gabim, pasi që në tabelar është paraqitur një shumë tjetër. Te tabelari nr.3 renditja e kategorive është në mënyrë të gabuar. Në vazhdim tha se struktura e të hyrave ka mundur me qenë shumë më e mirë. Gjithashtu tha se ka lëshime teknike në disa kategori të paraqitura nëpër tabela. Pastaj lidhur me projektet kapitale tha se struktura e projekteve kapitale është relativisht e kënaqshme në raport me relacionet tjera, por struktura e të hyrave vetjake do të duhej të përmirësohej. Poashtu participimi i planifikimit të buxhetit për shpenzimet në subvencionimin e bujqësisë nuk është i kënaqshëm. Mandej tha se për të gjitha projektet e propozuara është dashtë që në anekse të materialeve të paraqitet një elaborat i arsyeshmërisë së atyre projekteve dhe cili është benefiti i Komunës. Duke iu referuar planifikimit të buxhetit, tha se ka shumë zëra buxhetor që figurojnë zbrazët. Kurse sa i përket projekteve kapitale, shtoi se nuk është një shtrirje e balancuar, dhe propozoi në emër të grupit asambleistë të LDK-së urën Gllavotin-Prelluzhë, urën Pestovë-Druar, pastaj propozoi rrugën së bashku me rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimit Podrançë-Dobërllukë, rruga “Lumni Surdulli” – Nedakoc, ku në një pjesë duhet të ndërtohet urë mbi lumin, rruga magjistrale Bajskë, rruga “Haxhi Zeka”, gjithashtu propozoi edhe ndërtimin e këtyre shkollave: shkollat fillore në fshatin Bajskë, Karaçë dhe Pestovë.

Bajram Mulaku- sa i përket të hyrave vetanake, tha se të hyrat vetanake janë më të mira se në të kaluarën, duke shtuar se edhe përkundër këtij fakti nuk është i kënaqur edhe me këto të hyra. Gjithashtu u pajtua që duhet të bëhet një planifikim profesional, dhe për këtë me siguri nevojitet një zyrë e veçantë për planifikimin e të hyrave, duke përkrahur propozimin që të hyrat duhet të rriten sa më shumë. Mandej tha se participimi në bujqësi është i ulët, duke thënë se në mungesë të mundësisë për të realizuar projektet e planifikuara, është dashtë të shkurtohen. Kurse sa i përket propozimeve të reja që të futen për realizim me donacion, tha se mund të futen, por donacionet nuk kanë garancion. Ndërsa lidhur me çështjen e urës në Pestovë, tha se nuk e ka futur në prioritet pasi që nga dita e hënë KFOR-i do të fillon përsëri për ta rregulluar atë urë. Pastaj njoftoi se ka interesim të madh për ndërtimin e urës së Prelluzhës, duke shtuar se ka autorizuar Drejtorinë e Urbanizmit për të shpallur tenderin për hartimin e projektit për ndërtimin e urës në Prelluzhë. Ndërsa për rrugën Podrançë-Dobërllukë, u përgjigj se është vendimi i Kuvendit që prej mjeteve shtesë që teprojnë, të vazhdon asfaltimi i rrugës në fjalë. Pastaj rruga “Lumni

Surdulli” mund të futet përmes donacioneve, mandej për magjistralen Bajskë, tha se janë të planifikuara 30.000 € nga të hyrat vetanake dhe është projekt që vitin e ardhshëm do të realizohet. Rruga “Haxhi Zeka” është prej rrugëve të para me prioritet për vitin e ardhshëm. Në fund për ndërtimin e shkollave fillore, tha se për fshatin Zhilivodë është marrë vendim ndërtimi i shkollës, poashtu ekziton një projekt edhe për ndërtimin e shkollës në fshatin Bukosh, ndërsa për ndërtimin e shkollës në Pestovë, tha se është vështirë nëse do të mund të realizohet vitin e ardhshëm, prandaj për vitet tjera është në prioritet Pestova. Gjithashtu edhe në Maxhunaj ka nevojë që një pjesë e shkollës së vjetër të rrënohet dhe të ndërtohet ajo pjesë e re. Kurse për Karaçë, tha se është gjendja tepër keq, duke paraqitur si propozim bartjen e nxënësve nga fshati Karaçë për në shkollën fillore “Çajupi”.

Pajazit Pllana- duke iu referuar projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2011, asfaltimi i rrugëve Shtitaricë-Dolak, tha se Dolaku e ka kryer rrugën, kurse figuron në të njëjtën kolonë, dhe pyeti pse ka ndodh kjo, dhe kërkoi që të hiqet kjo, pasi që Dolaku e ka kryer rrugën e vet. Pastaj tha se fshati Shtitaricë nuk ka fituar asfalt, dhe nuk ka dalje në asfalt, ndërsa të gjitha fshatrat përreth kanë fituar edhe më tepër, dhe që të kthehen banorët në vendlindjen e vet, duhet t’iu krijohen kushtet dhe mundësitë që ky projekt të realizohet me rrugën e vjetër që lidhet prej varrezave, e deri në vendin e quajtur “bregu i dredhëzave”. Mandej kërkoi sqarim se si do të realizohet asfaltimi i rrugës Stacioni Hekurudhor-Bukosh-Novolan-BruzNIK-Kollë. Gjithashtu kërkoi që t’iu ipet prioritet të gjitha vendbanimeve dhe të ndahen në mënyrë të barabartë për të gjitha vendbanimet, në mënyrë që të kthehen banorët dhe jeta të zhvillohet në mënyrë normale.

Zeqir Hasani- sa i përket draft-buxhetit komunal për vitin 2011, tha se pasi që ka mundësi për riorientim të mjeteve, të mos përqendrohemi vetëm në ndërtimin e infrastrukturës së rëndë, pra vetëm në asfalte, kurse cilësia është mjaft e dobët, mbikëqyrja është katastrofale, duke shtuar se vetëm janë duke u shpenzuar mjetet e qytetarëve prej vitit në vit, pothuajse në projektet përafërsisht të njëjta. Poashtu propozoi që një pjesë e mjeteve të orientohet për rregullimin e ujit, rrymës, ambientit, pasi që qytetarët janë duke jetuar në kushte shumë të vështira, dhe tha se qyteti i Vushtrrisë është më i diskriminuar në Kosovë edhe sa i përket furnizimit me ujë dhe me rrymë. Gjithashtu kërkoi një angazhim më të madh nga dikasteret komunale për rritjen e të hyrave, pastaj kërkoi që në prioritet të futen ato investime, duke marrë parasysh kontributin e qytetarëve në pagesën e tatimit në pronë. Mandej tha se ka nevojë për riorientim mjetesh, duke shtuar se bujqësia është e lënë anash, dhe nëse Komuna thirret në atë se është duke u angazhuar për krijimin e vendeve të reja të punës, atëherë duhet që më shumë mjete të investohen në zhvillimin e bujqësisë, pasi që aty do të ketë rigjenerim të vendeve të punës. Poashtu kërkoi që të planifikohen mjete për zhvillimin e sportit dhe të rinisë, pasi që totalisht janë lënë anash, të ndahen mjete për mbrojtje të ambientit, të ndahen mjete për zhvillimin e sektorit të ekonomisë, pasi që në atë sektor nuk ka asnjë cent mjete. Në vazhdim tha se nuk është mirë të bëhet diskriminim i qytetarëve dhe në baza partiake të shtrohen rrugët, duke shtuar që 70 % të rrugëve janë të shtruara në baza partiake. Lidhur me ndërtimin e shkollave, propozoi që të ndërrohet një shkollë edhe në fshatin Sllakoc, kurse lidhur me ndërtimin e rrugëve, tha se ka mundur të hyn në prioritet edhe rruga për në Samadrexhë dhe Sfarçakë.

Besim Jashari- tha se në vazhdimësi do të insiston që dokumentet që iu dërgohen anëtarëve të Kuvendit, të jenë dokumente të qarta dhe të përgatitura mirë në të gjitha aspektet. Pastaj paraqiti vërejtje për gabimet teknike në paragrafin e dytë të draft buxhetit. Poashtu kërkoi që shkurtesat e paraqitura në draft buxhet të shoqërohen edhe me shpjegimin e tyre. Pastaj tha se buxheti është çështje vitale, dhe shtoi se rinia nuk po përkrahet. Mandej pyeti se cili është buxheti që ka ndarë Komuna për ta mbrojtur tokën bujqësore dhe pjellore në Vushtrri, dhe cili është buxheti i ndarë për të marrë masa për ta mbrojtur tokën tash e tutje, për ta stopuar

këtë trend shumë negativ. Ndërsa duke iu referuar ndërtimit të mburojave të bankinave, tha se duhet të ketë kontroll të vazhdueshëm, por për inspektim dhe kontroll nuk ka mjete të ndara, duke kërkuar që të ndahen mjete për inspektim dhe kontroll. Pastaj tha se janë dhënë mbi 90 mijë euro për drunjët dekorues, por duhet të mendohet si të mbahen gjallë, si të ruhen, dhe shtoi se në rrugën "Skënderbeu" janë disa drunjë që janë mbjellur nën disa drunjë të Shkollës së Policisë, kurse ka pjesë që nuk ka fare drunjë të mbjellur, dhe kjo nënkupton menaxhim jo të mirë të buxhetit. Gjithashtu tha se nuk është ndarë asnjë mjet për inspektimin e arsimit. Në fund duke iu referuar planifikimit të të hyrave vetanake, tha se planifikimi i të hyrave vetanake ka shumë rëndësi, prandaj propozoi që të jetë një sektor i analizave dhe të planifikimit, pasi që ka tjetër efekt kur dikush merret në mënyrë sistematike me plan dhe analizë.

Bajram Mulaku- tha se një ndër synimet e tij prej që ka ardhur në pushtet ka qenë dhe është që edhe nga qyteti edhe nga fshatrat të bëhet largimi i baltës. Pastaj duke bërë rrugë, duke ndërtuar infrastrukturën rrugore, edhe të ujërave të zeza, edhe të sistemit të ujit të pijshëm, fillohet të ndryshohet së pari jeta jonë, dhe i jepet mundësi zhvillimit ekonomik, rural dhe qendror, pra pa rrugë, pa infrastrukturë rrugore nuk ka zhvillim, nuk ka jetë të mirë, dhe shtoi se ka disa sektorë që nuk mund të mbulohen në mënyrë të mjaftueshme, duke përmendur nevojën e ndërtimit të infrastrukturës sportive për të rinjtë, poashtu fusha sportive e futbollit është në gjendje shumë të keqe, prandaj premtoi se këtë vit do të fillohet ndërtimi i disa fushave sportive. Ndërsa lidhur me ambientin, tha se deri më tani i kanë dhënë rëndësi të mjaftueshme rregullimit të ambientit, por më e rëndësishmja është mirëmbajtja. Gjithashtu njoftoi se është duke bërë përpjekje që kompaninë "Uniteti" ta kthen në kompani komunale, e jo të mbetet regjionale, pasi që në këtë formë nuk po funksionon. Pastaj njoftoi se i ka propozuar drejtorit që të hiqen të gjithë kontejnerët e mbeturinave nga qyteti, por drejtori nuk e ka përfillur propozimin e tij. Gjithashtu i ka propozuar që ta bën një projekt që secila familje dhe secili dyqan ta kenë nga një kontejner të veçantë, pasi që do të kishte edhe inkasim më të mirë, por edhe ndotja do të ishte më e vogël. Mandej duke iu referuar furnizimit me ujë, tha se ka përfunduar tenderi për ndërtimin e fabrikës së ujit, por tani gjendet në fazën e vlerësimit. Kurse lidhur me bujqësinë, tha se mjetet që kanë mbetur për subvencionim të bujqëve janë të vogla, mirëpo ka premtime të shumta prej komisionit evropian dhe prej donatorëve të shumtë ndërkombëtar që me bashkëfinancim të ndihmohen më tepër bujqit. Kurse sa i përket zhvillimit ekonomik, tha se është duke punuar në këtë drejtim, dhe përmendi si shembull dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës, poashtu një ndër metodat e zhvillimit ekonomik është ndërtimi i parkut të biznesit. Lidhur me ndërtimin e infrastrukturës rrugore, tha se nuk ka mbetur gati asnjë fshat që nuk është punuar në të. Ndërsa lidhur me vërejtjen për nxënien e tokave bujqësore, tha se është obligim i inspektionit, pasi që e ka të ndarë buxhetin për këtë punë, dhe shtoi se më së paku janë zënë toka bujqësore në këto tri vitet e fundit, në krahasim me të kaluarën, dhe shtoi se ekziston tenderi për shfrytëzimin e tokave bujqësore, i cili është në realizim e sipër. Në fund lidhur me asfaltimin e rrugës Stacioni Hekurudhor-Bukosh-Novolan-Bruznic-Kollë, tha se këtë vit janë ndarë 150.000 €, kurse nevojiten mbi 500.000 €, por shpreson se edhe përmes donacioneve do të arrin me realizuar asfaltimin e rrugës në fjalë.

Pas pauzës, në vazhdim të punimeve gjatë pjesës së dytë të seancës për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe këta anëtarë të Kuvendit:

Sabit Kadriu, Veli Karaça, Qazim Azemi, Sami Istrefi, Bahrije Pllana, Bajram Mulaku, Ferit Idrizi.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 23 vota “për”, 7 “kundër”, dhe 1 “abstenim” lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:
Aprovohet buxheti i Komunës dhe lista e projekteve prioritare për vitin 2011.

3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2011. (referues:Isuf Jashari)

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan:
Isuf Jashari, Ismet Gashi, Bajram Mulaku.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, 5 “kundër”, të tjerët “abstenim” lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:
Aprovohet Draft Rregullorja në fjalë.

Në vazhdim të seancës u vendos që të hiqet kjo pikë e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat buxhetore për muajin Korrik dhe Gusht 2011. (referues:Isuf Jashari)

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për plotësim të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale. (referues:Idriz Ismajli)

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan:
Idriz Ismajli, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Bajram Mulaku, Ismet Gashi.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas aprovimit në mënyrë unanime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim plotësohet rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale 01Nr.742/08, dt.30.12.2008.

Neni 8 i rregullores së cekur, përkatësisht në fund të nenit 8 shtohet paragraf i ri si vijon:

Pagesat për tarifat e përcaktuara në këtë nen mund të bëhen në maksimumi në tri këste :

- *Kësti i parë në vlerë prej 50% para marrjes së lejes ndërtimore,*
- *Kësti i dytë në vlerë prej 25% pasi të kryhen 50% e punëve ndërtimore të parapara me leje ndërtimore (kateve),*
- *Kësti i tretë në vlerë prej 25% pas mbulimit të objektit gjegjësisht pas kryerjeve të punëve të vrazhda ndërtimore.*

6. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për formimin e Bordit Këshillëdhënës për dhënien e këshillave në planet rregulluese të qytetit. (referues Idriz Ismajli).

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan:
Idriz Ismajli, Ismet Gashi, Xhylsime Feka, Sabit Kadriu, Besim Jashari, Xhevahire Izmaqu, Bajram Mulaku, Besim Jashari.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 22 vota “për”, 7 “kundër”, të tjerët “abstenim” lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:
Aprovohet vendimi për emërimin e Bordit Këshillues për dhënien e këshillave për hartimin e planeve rregulluese të qytetit të Vushtrrisë, në këtë përbërje: Xhevahire Izmaqu- kryesuese, Ferit Idrizi, Idriz Ismajli, Nezir Klinaku, Dibran Përçuku, Nasuf Aliu, Qerim Selimi, Safet Idrizi, Bajram Beqiri, Naim Hyseni, Qamil Sahiti,

Avdullah Halimi, Shpëtim Zhegrova, Naile Osmani, Ergin Sunguri, Sabit Kadriu, Makfirete Ademi, Sabri Ferati, Remzije Isufi.

7. Shqyrtimi i propozim vendimit për ridestitim të mjeteve për bashkëfinancim të projektit për rinovim të objektit të ish TMK-së në Vushtrri (vlera 14.416.50 €).(referues:Qamil Sahiti)

**Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan:
Bajram Mulaku, Veli Karaça.**

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit njëzëri lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet vendimi që nga buxheti i komunës, lejohen mjete financiare në shumë prej 15.000.00 € për renovim të objektit të ish TMK-së, Rr. “Skënderbeu” në Vushtrri, për vendosje të Arkivit Historik të Komunës.

Në vazhdim të seancës u vendos që të diskutohen bashkarisht këto pika të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i propozim vendimit për renovim të objektit – shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit, për muze të qytetit. (referues:Qamil Sahiti)

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit njëzëri lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet vendimi për ndarje të mjeteve buxhetore për renovim të objektit – shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit në Vushtrri

Nga buxheti i komunës lejohen mjete financiare në shumë prej 5.000.00 € për vitin 2010, për bashkëfinancim të projektit “renovimi i objektit – shtëpia e Mahmut Agë Gjinollit në Vushtrri”.

Projekti i cekur si në nenin paraprak të këtij vendimi do të realizohet me bashkëfinancim nga donatorë, në dy faza:

- *Faza e parë do të filloj së realizuari në këtë vit (2010), ndërsa*
- *Faza e dytë në vitin 2011.*

10. Shqyrtimi i propozim vendimit për rindërtim të Kullës së Azem Bejtes në Galicë. (referues:Qamil Sahiti)

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit njëzëri lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet vendimi për ndarje të mjeteve buxhetore për rindërtim të Kullës së Azem Bejtës në Galicë.

Nga buxheti i komunës lejohen mjete financiare në shumë prej 5.000.00 € për vitin 2010, për bashkëfinancim të projektit “rindërtimi i kullës së heroit tonë kombëtar Azem Bejta, në fsh. Galicë të Komunës së Vushtrrisë”.

Projekti i cekur si në nenin paraprak të këtij vendimi do të realizohet me bashkëfinancim nga donatorë, në dy faza:

- *Faza e parë do të filloj së realizuari në këtë vit (2010), ndërsa*
- *Faza e dytë në vitin 2011.*

9. Shqyrtimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të tokës ndërtimore pronë e Komunës.

**Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan:
Sabit Kadriu, Ismet Gashi, Sami Istrefi.**

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për”, 3 “kundër”, të tjerët “abstenim” lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:
*Aprovohet vendimi për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim të tokës ndërtimore pronë e Komunës Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës-PTK Sh.A nga Prishtina i lejohet për shfrytëzim toka ndërtimore, në sipërfaqe prej 0.01.00ha (100m²), e cila është pjesë e parcelës kadastrale P-70202029-00506-0, Komuna Kadastrale Svaraçak, evidentuar në fletën poseduese nr.70, pronë e Komunës së Vushtrrisë.***

11. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës. (referues:Idriz Muzaqi).

**Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan:
Ferit Idrizi, Bajram Mulaku.**

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit njëzëri lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:
*Aprovohet kërkesa e Kryetarit të Komunës dt. 21.09.2010 për fillimin e procedurës për ndryshimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.
Formohet komisioni për hartim të ndryshimeve të Statutit të Komunës së Vushtrrisë.
Në përbërje të komisionit caktohen:***

- *Ferit Idrizi, kryesues i komisionit*
- *Muharrem Shabani, anëtar*
- *Veli Karaqa, anëtar*
- *Idriz Muzaqi, anëtar*
- *Haki Maloku, anëtar.*

12. Shqyrtimi i propozim vendimeve për dhënien në shfrytëzim të përkohshme me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës sipas kërkesave të:

- **Musa Caka nga Stanovci i Epërm**
- **Jeton Klinaku nga Vushtrria**
- **Isa Hajrizi nga Vushtrria**
- **Haki Bekteshi nga Stanovci i Poshtëm,**
- **Kreshnik Basholli nga Vushtrria,**
- **Shyqyri Selmani nga Progovci Komuna e Prishtinës, (referues: Nasuf Aliu).**

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan:

Nasuf Aliu, Ferit Idrizi, Refik Ramaj, Zeqir Hasani, Sami Istrefi.

Pastaj përfaqësuesit e kërkesave i elaboruan planet e biznesit:

Musa Caka, Jeton Klinaku, Isa Hajrizi, Haki Bekteshi, Kreshnik Basholli, Shyqyri Selmani.

Kurse nga anëtarët e Kuvendit diskutuan:

Sabit Kadriu, Abdullah Halimi, Tasim Gubetini, Sami Istrefi, Bajram Mulaku, Ferit Idrizi.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 17 vota “për”, 2 “abstenim” lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim plotësohet vendimi i kuvendit të komunës së Vushtrrisë 01Nr.127/10 dt. 27/05/2010.

Në nenin 1 të vendimit të njejt sipërfaqes prej 02.00.00 ha, në ngastrën e njejtë kadastrale, i shtohet ngjitas sipërfaqja prej 01.00.00 ha. Kjo sipërfaqe gjithashtu ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim personave të interesuar për zhvillim të veprimtarive shërbyese, prodhuese, tregtare.

Sqarim: gjatë kësaj pike të rendit të ditës, nuk kanë marrë pjesë as në shqyrtim dhe as në votim grupi asambleistë i AAK-së dhe ai i LDK-së, duke e lëshuar sillën ku mbahej seanca e Kuvendit.

13. Eventuale:

a. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të komunës në Vushtri;

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan:

Bajram Mulaku, Sami Istrefi, Sabit Kadriu, Muharrem Shabani, Veli Karaça, Bajram Mulaku, Xhevahire Izmaku, Besim Jashari.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, 7 “kundër”, të tjerët “abstenim” lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Komunës në Vushtri.

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit të Komunës në Vushtri në ngastrën kadastrave nr.667, në vendin e quajtur “Qytet” me kulturë jo pjellore, në sipërfaqe prej 0,31.24 ha, fleta poseduese nr.45, Zona Kadastrale Vushtri, pronë e Komunës së Vushtrrisë (lokacioni i tregut të tanishëm në qendër të qytetit).

b. Kërkesë për rritje të të hyrave vetanake për shkollat e mesme profesionale të komunës për v. 2010-2011;

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan:

Idriz Muzaqi.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas aprovimit njëzëri lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet vendimi për rritjen e të hyrave vetanake për v. 2010 dhe 2011.

Me këtë vendim rriten të hyrat vetanake të komunës për SHMT “Lutfi Musiqi” dhe SMP “Bahri Haxha” në Vushtri, për vitin 2010 në shumë prej 25.750.00 € dhe për vitin 2011 në shumë prej 28.250.00 €.

c. Kërkesë për marrje me qira të pronës së komunës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan:

Bajram Mulaku, Idriz Muzaqi.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 20 vota për”, të tjerët “abstenim” lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet vendimi për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim (me qira) të pronës së paluajtshme të Komunës.

Me këtë vendim i ipet në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim (me qira), Bankës Kombëtare Tregtare dega në Kosovë, në shumë prej 1.300 € në muaj, parcela Kadastrale P-70202016-00127-0, vendi i quajtur VAROSH/MARSHALLA TITA, (rruga “Dëshmorët e Kombit”), në sipërfaqe prej 344 m², (trolli dhe kati përdhese i objektit i cili gjendet në këtë parcelë), fleta poseduese UL-70202016-03960, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në orën 17:35.

Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi

SQARIM:

Për shkak të dështimit të teknikës, me rastin e incizimit të pjesës së dytë të mbledhjes, nuk ka qenë e mundur të shënohen në procesverbal diskutimet e pjesëmarrësve të mbledhjes në fjalë.